

Sistemi i kompjuterizuar i KMSHC, vijonë konsultimet për avancimin e procesit

Nën kujdesin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Leterije Lleshi (Luzi), vijojnë takimet konsultative me drejtoritë e Institucionit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC) dhe specialistët e teknologjisë së informacionit, për të përparuar me ngritjen e sistemit të kompjuterizuar gjithëpërfshirës të veprimtarisë institucionale, bazuar në Rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë.



Sistemi i kompjuterizuar i KMSHC-së do të ndihmojë në rritjen e transparencës dhe komunikimit publik, duke vlerësuar rolin kyç të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për monitorimin e zbatimit të ligjit “Për nëpunësin civil”, në të gjitha institucionet e qeverisjes qendrore, njësisive të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve të pavarura.



Po ashtu sistemi i kompjuterizuar i KMSHC-së do të lehtësojë edhe mbikëqyrjen e orientuar për mbledhjen e informacionit, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, në të gjitha institucionet e administratës shtetërore, si dhe procesin e e rekrutimeve të kryera nga Departamenti i Administratës Publike dhe administratës vendore.